



VENDIMI MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 12 shkurt 2020

Nr. i lëndës: 2016-18

P.K.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 12 shkurt 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Ankuesja kërkoi që mos t'i zbulohet identiteti i saj. Duke marrë parasysh çështjen, në veçanti natyrën e pretendimeve që bëhen, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli") është i bindur që kërkesa duhet të pranohet.
3. Me letrën e datës 1 korrik 2016, Paneli informoi Misionin se kjo lëndë ishte regjistruar.
4. Më 28 qershor 2017, Paneli kërkoi nga ankuesi përmes përfaqësuesit për familjet serbe të Qendrës së Personave të Zhdukur (MPPK), një OJQ me qendër në Prishtinë, të sigurojë informata shtesë. Ankuesi nuk dha ndonjë përgjigje.
5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i dërgoi një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shefit të Misionit (ShM), EULEX-it Kosovë, duke e ftuar Misionin të paraqesë përgjigje dhe vërejtje me shkrim për ankesat jo më vonë se me datën 26 janar 2018.

6. Me letrën e datës 19 janar 2019, Misionit iu kërkua të jepte përgjigje për pyetjet deri më datën 16 shkurt 2019.
7. Me letrën e datës 8 prill 2019, nga Misioni u kërkua përsëri të sigurote përgjigje për pyetjet sa më shpejt që ishte e mundur.
8. Me letrën e datës 20 qershor 2019, Paneli e njoftoi ankuesen se ishte ende në proces të trajtimit të ankesës së saj.
9. Me letrën me vulë postare të datës 23 shtator 2019, ankuesja dha dëshmi dokumentare për identitetin dhe marrëdhënien e saj me viktimën.
10. Më 18 tetor 2019, ushtruesi i detyrës së ShM-së paraqiti vërejtjet e tij për rastin.
11. Më 21 tetor 2019, letra e ushtruesit të detyrës së ShM-së iu dërgua për informacion ankuesit, të cilit iu dha afat deri më 22 nëntor 2019 për të bërë parashtresa të tjera në përgjigje të asaj letre.
12. Ankuesi nuk e shfrytëzoi mundësinë për të bërë parashtresa shtesë.

II. FAKTE

13. Më 2 gusht 1999, babai i ankueses shkoi të vizitojë varrin e djalit të tij në varrezat ortodokse serbe në pjesën jugore të Mitrovicës. Ai nuk u pa dhe as nuk u dëgjua asgjë më nga ai.
14. Në data të papërcaktuara, ankuesja raportoi zhdukjen e babait të saj në KFOR, Kryqin e Kuq dhe Qendrën për Paqe dhe Tolerancë të Republikës së Serbisë.
15. Më 9 shkurt 2000, një trup u gjet në fshatin Mirash.
16. Më 30 mars 2000, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) hapi një kërkesë për gjurmim për babanë e ankueses.
17. Më 21 nëntor 2002, Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësia Ligjore (OMPF) e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) kreu një autopsi në trupin që u gjet në 9 shkurt 2000. Autopsia renditi shkakun e vdekjes si *“lëndime me armë zjarri në kokë dhe gjoks”*.
18. Më 22 qershor 2003, Njësia e Personave të Zhdukur të UNMIK-ut lëshoi një Certifikatë Identifikimi për babanë e ankueses.
19. Më 23 qershor 2003, Zyra e Ekzaminuesit Mjekësor, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut, lëshoi një certifikatë vdekjeje për babanë e ankueses. Shkaku i vdekjes u verifikua nga një autopsi dhe u regjistrua si *“plagosje me armë në kokë dhe gjoks”*.
20. Më 28 korrik 2003, OMPF konfirmoi identifikimin e trupit përmes analizave të ADN-së. Certifikata për Konfirmimin e Identitetit e vë në listë nënën dhe dy motrat e viktimës si dhurues gjaku për analizë të ADN-së, por nuk e vë në listë ankuesen.
21. Më 13 gusht 2003, mbetjet mortore të babait të ankueses iu dorëzuan ankuesit nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore të UNMIK-ut.

III. ANKESA

22. Ankuesja pretendon se në një datë të paspecifikuar ajo i dha gjak Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (OMPF) të UNMIK-ut me qëllim të analizës së ADN-së për identifikimin e babait të saj. Sidoqoftë, Certifikata e Konfirmimit të Identitetit rendit vetëm nënën e babait të saj dhe dy motrat si burim gjaku për analizë të ADN-së.
23. Ankuesja pretendon se pas identifikimit të trupit të babait të saj në 2003, ZPZHML-ja mohoi që babai i saj kishte një vajzë. Që nga ajo kohë, ankuesja pohon se nëna dhe motra e babait të saj kanë mohuar që ajo është vajza e babait të saj. Ankuesja pretendon se kjo i ka shkaktuar shqetësime të mëdha.
24. Ankuesja kërkon nga EULEX-i që t'i sigurojë asaj qasje në mostrën e gjakut që ajo i dha OMPF dhe të sigurojë një analizë të ADN-së, në mënyrë që të dëshmojë se ajo është në fakt vajza biologjike e babait të saj.

IV. PARASHTRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË

Shefi i Misionit ("ShM")

25. Në parashtrimet e tij, ShM-ja tregon se, kërkesa kryesore e ankuesit në Mision është që EULEX-i ta ndihmojë atë të gjejë analizën e ADN-së të mostrës së gjakut që ajo pretendon se ajo e ofroj për të identifikuar babanë e saj, me qëllim që të dëshmojë që ajo është vajza biologjike e këtij njeriu. Kjo kërkesë nuk mund të përmbushet nga EULEX-i dhe duhet t'i drejtohet autoriteteve kompetente në Prishtinë dhe Beograd. Mbledhja e mostrave të gjakut dhe identifikimi i trupit u bë nga autoritetet përkatëse përpara se mandati i EULEX-it të fillonte në dhjetor 2008. Çfarëdo gabimi i supozuar në përpunimin e mostrave të gjakut në asnjë mënyrë nuk mund t'i atribuohet EULEX-it.
26. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, dhe duke marrë parasysh kërkesën specifike të ankueses, Misioni gjykon që kërkesa të shpallet qartazi e pabazuar ose e papranueshme *ratione materiae*.

V. VLERSIMI I PANELIT

27. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
28. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
29. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.

30. Paneli vëren se lënda e ankesës është verifikimi i lidhjes familjare të ankueses me babanë e saj për qëllime të të cilave ajo kërkon të marrë mostrat e gjakut, për të cilat thuhet se ishin marrë prej saj.
31. Ankuesja nuk përmend se cili veprim i Misionit do të ishte relevante për ankesën e saj ose bazën në të cilën ajo sugjeron që një veprim i tillë mund të thuhet se ishte pjesë e mandatit ekzekutiv të Misionit. E as ankuesja nuk ka treguar ose paraqitur dëshmi të një dështimi të fajshëm që mund t'i ngarkohet EULEX-it.
32. Për më tepër, ankesa ka të bëjë me veprimet e Zyrës për Personat e Zhdukur dhe Mjekësinë Ligjore (OMPF) të UNMIK-ut, e cila i parapriu EULEX-it dhe veprimet e së cilës nuk mund t'i ngarkohen Misionit.
33. Bazuar në atë që u përmend më sipër, është e qartë se EULEX-i nuk ishte përfshirë në asnjë mënyrë në ndonjë aktivitet të rëndësishëm rreth kësaj ankese.
34. Për më tepër, siç sqaron ShM-ja në parashtresat e tij, EULEX-i nuk është kompetent në lidhje me kërkesën e ankueses për qasje në mostrat e gjakut ose dëshminë e ADN-së të mbajtura nga autoritetet vendore. E as nuk është vërtetuar se Misioni ndryshe ishte kompetent për këtë çështje dhe nuk arriti në mënyrë arbitrare të përfshihej në këtë çështje.
35. Nga kjo rrjedh se kjo ankesë bie jashtë mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe rrjedhimisht jashtë kompetencave të Panelit, siç është saktësuar në Rregulloren 25 të Rregullores së tij të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë. Prandaj ankesa është jashtë kompetencës së Panelit dhe është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli konstaton njëzëri se ankesa nuk hyn në fushën e juridiksionit të PShDNj-së në kuptimin e Rregullit 29, 1(d) të Rregullores së tij të Procedurës, dhe është qartazi e pabazuar në përputhje me Rregulloren 29, 1(e) të Rregullores së tij të Punës.

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Guénaél METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare

